



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____/____/2026

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË BUXHETIT DHE VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025 ,BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,i ndryshuar, neni 48 “ Monitorimi dhe zbatimi i buxhetit vendor”, Ligji nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” , Udhëzim nr.2 datë 24.01.2025 ‘Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” Udhëzim nr.35 datë 29.12.2023 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore”,Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e monitorimit të Buxhetit dhe vlerësimin e përgjithshëm financiar , për periudhën Janar-Dhjetor viti 2025,për Bashkinë Përmet.
2. Ky vendim shpallet menjëherë dhe hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PERMET**

P/VENDIM

Nr. ____ DATE _____

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR. 113 DATË 17.12.2025 "PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË VITI 2026**

**DHE PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE
ADMINISTRATIVE NE VARËSI TË SAJ**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Per marrëveshjet nderkombetare në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.775 datë 24.09.2010 "Per administrimin e financimeve te huaja", Udhëzim nr.10 datë 12.07.2024 "Per rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombetare", Ligji nr.87/2025 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë ,institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj", Shkresës nr. 18273 datë 29.12.2025 "Dërgohet transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026 " protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, Shkresa nr.18059/1 datë 24.12.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025" protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, Shkresa nr.18133/1 datë 24.12.2025 "Detajimi i Fondit të Grantit të bazuar në performancë për Bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit", Shkresës nr.764 datë 19.12.2025 " Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025 " fondet me burim financimi nga financim i huaj protokolluar me tonën nr.4347 datë 30.12.2025 ,VKM nr.103 datë 11.02.2026 Për disa ndryshime në VKM nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore " ,të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ,

VENDOSI:

1.Të shtohen zërat e të ardhurave si më poshtë:



Të shtohen të ardhurat e mbartura të bashkisë nga viti 2025 në vlerën 8 692 940 lekë me kapitull

1.2 Të shtohet transferta e pakushtëzuar e mbartur nga vitin 2025 në vlerën 10 180 757 lekë me kapitull 01.

1.3 Të shtohet transferta e pakushtëzuar sektoriale nga viti 2025 në vlerën 21 356 170 lekë me kapitull 01.

1.4 Të shtohet Grandi i performancës për vitin 2025 nga buxheti i shtetit në vlerën 3 056 179 lekë me kapitull 01.

1.5 Të shtohet Grandi i performancës për vitin 2025 me financim të huaj në vlerën 3 777 716 lekë me kapitull 02.

2. Të shtohen shpenzimet në strukturat e mëposhtme:



lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600	601	602	604	606	609	230	231	Përshkrimi
01110	AA135	V111AAA	05	856898	143102							Paga e sigurime per stafin e administrates
01110	AA135	V111AAG	01			2387749						Detyrime për vendime gjyqësore
01110	AA135	V111AAD	01			250000						Blerje tonera
01110	AA135	P111AAG	01								410000	Blerje pajisje elektornike për Serverin
05100	AB135	V510AAA	01	856898	143102							Paga e sigurime per punonjesit e pastrimit
05100	AB135	V510AAB	01			841992						Materiale MRF

05100	AB135	P510AAC	01								15420000	Blerje automjete
06260	AB135	V626AAA	01	732479	122324							Paga e sigurime per punonjesit e gjelberimit dhe brigades
04260	AB135	V426AAA	01	151710	25336							Paga e Sigurime per punonjesit e pyjores
04240	AB135	V424AAB	01	181680	30340							Paga e sigurime per punonjesit e Bordit te kullimit
04240	AB135	P424XXX	01								1427533	Oponence teknike per Lotin e I dhe te II te Perroit te Bardhe dhe te tjera
04520	AB135	V452AAA	01	487200	81362							Paga e sigurime per punonjesit e rrugeve rurale
04520	AB135	P452AEJ	01							3056179		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi nga Grandi i Performances buxhet shteti



04520	AB135	P452AEJ	02							3777716		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi Grand performance financim i huaj
04520	AB135	P452AEJ	05							4053243		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi nga te ardhurat e trasheguara
04520	AB135	P452AEJ	01							3974896		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi nga transferta e pakushtezuar e trasheguar
10430	AC135	V043AAA	01	254796	42551							Paga e sigurime per punonjesit e perfshirjes sociale
10430	AC135	V043AAK	01			489490		300000				Bashkefinancim fondi social dhe



												transferta te individe
10430	AC135	V043AAK	05			1000000						Fond social
09120	AC135	V912AAA	01	632065	105555							Paga e sigurime per punonjesit e arsimit baze
09120	AC135	P912AAU	01								547910	Detyrim për Shkollën Meleq Gosnishti
09120	AC135	P912AAU	05								389697	Detyrim për Shkollën Meleq Gosnishti
09230	AC135	V923AAA	01	85689	14311							Paga e sigurime per Arsimin e mesem
09230	AC135	V923AAB	01			311585						Shpenzime per arsimin e mesem
09230	AC135	V923AAB	01				936060					Transferte Konvikti
08220	AD135	V822AAA	01	85689	14311							Paga sigurime per punonjesit e kultures
08220	AD135	V822AAD	05			500000						Aktivitete kulturore



03280	AE135	V328AAB	05	42845	7155							Paga e sigurime per punonjesit mbrojtjes se konsumatorit
03280	AE135	V328AAB	01	192314								Paga per punonjesit e MNZ
03140	AE135	V314AAB	05	1028277	171723							Paga e sigurime për patrullim e sigurinë publike
04940	AE135	V494AAA	05						500000			Fond rezervë



3.Të miratohen ndryshimet buxhetore të mëposhtme:

3.1Të pakësohen zërat buxhetorë:



Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600	601	602	604	606	609	230	231	Përshkrimi
04520	AB135	P452AAM	05								5000000	Rikonstrukcion Rruga Qilarisht
10430	AC135	V043AAF	01			1038000						Bashkefinancim për projektin "Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë"
10430	AC135	V043AAB	01			150000						Bashkefinancim për projektin "Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë" pagesë për OBP

3.2 Të shtohen zërat buxhetorë :

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600	601	602	604	606	609	230	231	Përshkrimi
04520	AB135	P452AAK	05								5000000	Rikonstruksion Rrugë rurale dhe urbane
10430	AC135	V043AAK	01			1188000						Bashkefinancim për projektin "Përqaftimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë"

4.Pika 8 e VKB nr.113 datë 17.12.2025 ndryshohet si më poshtë:

Të shtohet :

Numri i punonjësve për projektin “ Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë” të jetë 1(një).

5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet Financës dhe Drejtoritë e tjera.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA



SECRETARIA
ALMA PERMET



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PERMET**

RELACION

PËR

P/VENDIM

Nr. ____ DATE _____

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR. 113 DATË 17.12.2025 "PËR
MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË VITI 2026**

**DHE PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE DHE NJËSIVE
ADMINISTRATIVE NE VARËSI TË SAJ"**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin fmanciar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.43/2016 "Per marrëveshjet nderkombetare në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.775 datë 24.09.2010 "Per administrimin e financimeve te huaja", Udhëzim nr.10 datë 12.07.2024 "P e r rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve te financimeve të huaja në kuadrin e marreveshjes nderkombëtare", Ligji nr.87/2025 datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë viti 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë ,institucioneve dhe njësive administrative në varësi të saj", Shkresës nr. 18273 datë 29.12.2025 "Dërgohet transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026 " protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, Shkresa nr.18059/1 datë 24.12.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025" protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025, Shkresa nr.18133/1 datë 24.12.2025 "Detajimi i Fondit të Grantit të bazuar në performancë për Bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit", Shkresës nr.764 datë 19.12.2025 ' Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025 " fondet me burim financimi nga financim i huaj protokolluar me tonën nr.4347 datë 30.12.2025 ,VKM nr.103 datë 11.02.2026 Për disa ndryshime në VKM nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore " ,të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, kërkojmë miratimin e zërave buxhetorë për sa më poshtë vijnë:



Pas akordimeve me Degën e Thesarit rezultuan që nga viti 2025 do të mbartim zërat e të ardhurave të realizuar më tepër se vlera që priteshin të realizoheshin për vitin 2025 dhe kryesisht ishin pagesa të prapambetura nga bizneset si dhe derdhjet nga tatimi mbi të ardhurat dhe nga DRTSH (taksa e mjeteve të përdorura). Sipas shkresës nr.18059/1 datë 24.12.2025 "Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.11 datë 19.12.2025" protokolluar me tonën nr.4348 datë 30.12.2025 për bashkinë përmet u akorduan 2935659 lekë që kryesisht duhet të shkonin për detyrimet e prapambetura.

Ju bëjmë me dije se pas miratimit të buxhetit për vitin 2026 janë dokumentuar zyrtarisht Vendime për procese gjyqësore të periudhave të hershme që prej vitit 2017 të cilat pasi kanë përfunduar të gjitha shkallët e gjykimit kanë gjeneruar detyrime gjyqësore për ne. Këto vlera sipas vendimeve respektive janë bërë pjesë e shpenzimeve të paraqitura në këtë material që mbulohen nga këto të ardhura të deleguara nga niveli qendror.

Konkretisht vendimet :

1. Vendimi nr.654 datë 08.11.2017 me objekt Përmbushje detyrimi kontraktual pagesën e shumës 2493075 garanci dhe shpërblim dëmi sipas kushteve të kontratës me palë kreditore H.E.L.D.I Construction SHPK .Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr.08(86-2025-59) i depozituar me shkresën nr.88 datë 14.01.2026 protokolluar me tonën nr.180 datë 16.01.2026 nga Zyra përmbartimore "Elite Bailiff's office" shpk për ekzekutimin e këtij vendimi.

2. Vendimi nr.151 datë 13.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me objekt Detyrim i palës së paditur Bashkia Përmet të paguajë diferencën e pagës së papaguar për shkak të rritjes së pagës në bazë të VKM nr.165 datë 02.03.2016 për ish punonjësen, I.A.Ky vendim është ankimuar brënda afateve ligjore dhe sipas Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr.778 datë 12.05.2025 është vendosur detyrimin e Bashkisë për të paguar diferencat e pagës në vlerë 19680 lekë sëbashku me shpenzimet gjyqësore.

3. Vendimi nr.139/22-2018-305 datë 14.09.2018 me objekt Përmbushje detyrimi kontraktual duke paguar vlerën e faturave telefonike si dhe kamatat me palë kreditore Albtelecom Sh.A sot One Albania dhe përthithur kjo e drejtë nga Shoqëria D&A Fin Partner SH.P.K. Kjo njoftuar me shkresën për përmbushjen e detyrimit nr.470003/228235 datë 29.12.2025 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.05 datë 05.01.2026 në vlerën 328035 lekë.

Sipas shkresës nr.18133/1 datë 24.12.2025 "Detajimi i Fondit të Grantit të bazuar në performancë për Bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit" si dhe Shkresës nr.764 datë 19.12.2025 " Shkresë përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të KVA-së në kuadër të GBP 2025 " fondet me burim financimi nga financim i huaj ,protokolluar me tonën nr.4347 datë 30.12.2025 Bashkia Përmet ka përfituar :

- shumën 3 056 179 lekë grand performance me financim nga buxheti i shtetit
- shumën 3 777 716 lekë grand performance me financim të huaj nga Qeveria Zviceriane

Këtyre dy shumave Bashkia i ka shtuar dhe nga fondet e veta me grand dhe të ardhura dhe vlerën 8028139 lekë dhe në total ka parashikuar të hartojë Projektim me objekt "Rehabilitim i Lagjes së Rë" në vlerë totale 14 862 034 lekë.

Theksojmë se në këtë material janë parashikuar fondet e nevojshme për paga e sigurime për të kryer indeksimin e minimeve për pagën e pozicionit për çdo klasë sipas VKM nr.103 datë 11.02.2026 Për disa ndryshime në VKM nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve ,grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar ,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetqeverisjes vendore " ,të ndryshuar.



1. Të shtohen zërat e të ardhurave si më poshtë:

1.1 Të shtohen të ardhurat e mbartura të bashkisë nga viti 2025 në vlerën 8 692 940 lekë me kapitull 05.

1.2 Të shtohet transferta e pakushtëzuar e mbartur nga vitin 2025 në vlerën 10 180 757 lekë me kapitull 01.

1.3 Të shtohet transferta e pakushtëzuar sektoriale nga viti 2025 në vlerën 21 356 170 lekë me kapitull 01.

1.4 Të shtohet Grandi i performancës për vitin 2025 nga buxheti i shtetit në vlerën 3 056 179 lekë me kapitull 01.

1.5 Të shtohet Grandi i performancës për vitin 2025 me financim të huaj në vlerën 3 777 716 lekë me kapitull 02.

2. Të shtohen shpenzimet në strukturat e mëposhtme:

lekë

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	602 (shpenzime operative)	604 (transferta)	606 (transferta te individë)	609 (fond rezervë)	230 (projektime)	231 (investime)	Përshkrimi
01110	AA135	V111AAA	05	856898	143102							Paga e sigurime per stafin e administrates
01110	AA135	V111AAG	01			2387749						Detyrime për vendime gjyqësore
01110	AA135	V111AAD	01			250000						Blerje tonera
01110	AA135	P111AAG	01								410000	Blerje pajisje elektornike për Serverin
05100	AB135	V510AAA	01	856898	143102							Paga e sigurime per punonjesit e pastrimit



05100	AB135	V510AAB	01			841992						Materiale MRF
05100	AB135	P510AAC	01								15420000	Blerje automjete
06260	AB135	V626AAA	01	732479	122324							Paga e sigurime per punonjesit e gjelberimit dhe brigades
04260	AB135	V426AAA	01	151710	25336							Paga e Sigurime per punonjesit e pyjores
04240	AB135	V424AAB	01	181680	30340							Paga e sigurime per punonjesit e Bordit te kullimit
04240	AB135	P424XXX	01								1427533	Oponence teknike per Lotin e I dhe te II te Perroit te Bardhe dhe te tjera
04520	AB135	V452AAA	01	487200	81362							Paga e sigurime per punonjesit e rrugeve rurale
04520	AB135	P452AEJ	01							3056179		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me

												burim financimi nga Grandi i Performances buxhet shteti
04520	AB135	P452AEJ	02							3777716		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi Grand performance financim i huaj
04520	AB135	P452AEJ	05							4053243		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi nga te ardhurat e trasheguara
04520	AB135	P452AEJ	01							3974896		Projektim për objektin Rehabilitim i Lagjes se Re me burim financimi nga transferta e pakushtezuar e trasheguar



10430	AC135	V043AAA	01	254796	42551							Paga e sigurime per punonjesit e perfshirjes sociale
10430	AC135	V043AAK	01			489490		300000				Bashkefinancim fondi social dhe transferta te individe
10430	AC135	V043AAK	05			1000000						Fond social
09120	AC135	V912AAA	01	632065	105555							Paga e sigurime per punonjesit e arsimit baze
09120	AC135	P912AAU	01							547910		Detyrim për Shkollën Meleq Gosnishti
09120	AC135	P912AAU	05							389697		Detyrim për Shkollën Meleq Gosnishti
09230	AC135	V923AAA	01	85689	14311							Paga e sigurime per Arsimin e mesem
09230	AC135	V923AAB	01			311585						Shpenzime per arsimin e mesem
09230	AC135	V923AAB	01				936060					Transferte Konvikti

08220	AD135	V822AAA	01	85689	14311							Paga sigurime per punonjesit e kultures
08220	AD135	V822AAD	05			500000						Aktivite kulturore
03280	AE135	V328AAB	05	42845	7155							Paga e sigurime per punonjesit e mbrojtjes se konsumatorit
03280	AE135	V328AAB	01	192314								Paga per punonjesit e MNZ
03140	AE135	V314AAB	05	1028277	171723							Paga e sigurime për patrullim e sigurinë publike
04940	AE135	V494AAA	05						500000			Fond rezervë

Për vitin 2025 ishte parashikuar se nga kontrata e rrugës Qilarisht do të likujdohej në vlerën 4000 000 lekë por me realizimin e të ardhurave kjo vlerë u krye në shumën 9 000 000 lekë .Këtë sistemim po e paraqesim nëpërmjet këtij ndryshimi .Pra në buxhetin fillestar vlera e parashikuar për likujdim të kontratës ishte parashikuar 25121000 lekë(sëbashku me supervizim dhe kolaudim) duke zbritur 5000000 lekë rezulton vlera që nevojitet për të zbatuar kontratën.Kjo vlerë është sygjëruar të shkojë për zërin Rikonstruksion i Rrugëve rurale dhe urbane që ishte parashikuar në fillim të viti 2026 në vlerën 7 695 000 lekë të shtohet me 5 000 000 lekë pra në total shkon 12 695 000 lekë.

Fondet për bashkëfinancimin e fondit social për projektin “Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë” ishin parashikuar në kod projektet V043Aaf dhe V043AAB por sipas shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale këto fonde duhet të parashikoheshin në kod projektin V043AAK.Nga ky projekt paguhet dhe një punonjës që shërben të qënra dhe ne e kemi shtuar si për çdo projekt edhe këtë punonjës.

3.Të miratohen ndryshimet buxhetore të mëposhtme:

3.1Të pakësohen zërat buxhetorë:

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	602 (shpenzime operative)	604 (transferta)	606 (transferta te individë)	609 (fond rezervë)	230 (projekte)	231 (investime)	Përshkrimi
04520	AB135	P452AAM	05								5000000	Rikonstruksion Rruga Qilarisht
10430	AC135	V043AAF	01			1038000						Bashkefinancim për projektin “Përqafimi i

												shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë”
10430	AC135	V043AAB	01			150000						Bashkefinancim për projektin “Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë” pagesë për OBP

3.2 Të shtohen zërat buxhetorë :

Struktura	Programet	Kod Produkti	Kap	600 (paga)	601 (sigurime)	602 (shpenzime operative)	604 (transferta)	606 (transferta te individë)	609 (fond rezervë)	230 (projekte)	231 (investime)	Përshkrimi
04520	AB135	P452AAK	05								5000000	Rikonstrukcion Rrugë rurale dhe urbane
10430	AC135	V043AAK	01			1188000						Bashkefinancim për projektin "Përqafimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë"

4.Pika 8 e VKB nr.113 datë 17.12.2025 ndryshohet si më poshtë:

Të shtohet :

Numri i punonjësve për projektin “ Përqaftimi i shpresës ,një oaz për ata që kanë nevojë” të jetë 1(një).

Ju faleminderit!

Konceptuan:

Oltion Krew
Zenet Jona
Klaudja Cico
Elena Syftem
Dorian Hethaj
Enesa Jushe

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Përmet, më _____.2026

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 116 DATË 17.12.2025 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR TË BASHKISË PËRMET DHE TË INSTITUCIONEVE QË VAREN PREJ SAJ, PËR VITIN 2026”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika ç, VKM nr.177 datë 08.03.2017” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, **VKB NR.113 datë 17.12.2025** “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, **VKB Nr 116 datë 17.12.2025**” Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj për vitin 2026 ndryshuar me VKB Nr 02 datë 23.01.2026, **VKM nr.103** datë 11.02.2026 Per disa ndryshime ne Vendimin nr 328 date 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore, **VKM Nr. 104**, datë 11.2.2026 “Për një ndryshim në vendimin nr.419, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

I. Të miratojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të bashkisë sipas VKM Nr 103 datë 11.02.2026 ,për pozicionet si më poshtë:

1. Përgjegjës sektori ,Klasa III-3 shtesë/pozicioni..... 66.625-102.000 lekë / muaj
2. Specialist me arsim të lartë, Klasa IV-3 shtesë /pozicioni43.000-75.000 lekë/ muaj

3.Specialist me arsim të lartë,Klasa IV-4 shtese /pozicioni41000-65.000 lekë/ muaj

II.Të miratojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të MZSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, si vijon:

1.Pagat e punonjësve të MZSH-së sipas **VKM Nr.104 datë 11.02.2026**

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

IV. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej dates 01.01.2026

KRYETAR I BASHKISË
ALBA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



RELACION PËR P/V: PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 116 DATË 17.12.2025 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR TË BASHKISË PËRMET DHE TË INSTITUCIONEVE QË VAREN PREJ SAJ, PËR VITIN 2026”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, pika ç, VKM nr.177 datë 08.03.2017” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, **VKB NR.113 datë 17.12.2025** “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj, **VKB Nr 116 datë 17.12.2025**” Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, të Bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj për vitin 2026 ndryshuar me VKB Nr 02 datë 23.01.2026, **VKM nr.103** datë 11.02.2026 Për disa ndryshime në Vendimin nr 328 date 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore, **VKM Nr. 104**, datë 11.2.2026 “Për një ndryshim në vendimin nr.419, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i propozojmë Këshillit Bashkiak

I.Të zbatojë nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të bashkisë sipas VKM Nr 103 datë 11.02.2026 ,për të kryer indeksimin e minimumit për pozicionet si më poshtë

	Emertimi i pozicionit të punës	Paga e pozicionit (Ishte)	Paga e pozicionit (Bëhet)
1	Përgj.sektori Klasa III-3	65.000-98.000	66.625-102.000
2	Specialist Klasa IV-3	42.000-75.000	43.000-75.000
3	Specialist Klasa IV-4	40.000-60.000	41000-65.000



II. Të zbatohet nivelin e pagave dhe shpërblimeve të punonjësve të MZSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, si vijon:

1. Pagat e punonjësve të MZSH-së sipas VKM Nr.104 datë 11.02.2026

Niveli	Grada	Paga baze (Ishte)	Pagabaze (Bëhet)
Niveli baze	Asistent Zjarrfikes	60.000	65,000
	Zjarrfikes	65.000	69,000
	Kryezjarrfikes	70.000	73,500
Niveli i mesem	Inspektor Zjarrfikes	75.000	78,000
	Kryeinspektor Zjarrfikes	85.000	88,000

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

IV. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej dates 01.01.2026

Konceptoi: Klevisa Çipi

Miratoi: Z. Jaçe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM
NR. _____ DATË _____

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.100,DATË 04.12.2025,"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE,BASHKIA PËRMET,VITI 2026".

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar , Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë ", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" , i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksë",Paketës Fiskale të vitit 2026,miratuar me vendim nr.100,datë 04.12.2025, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

I.Të shtohet në paketën fiskale zërat si më poshtë:

1.Niveli i Taksës së Fjetjes në hotel për vitin 2026 për Bashkinë Përmët, të jetë sipas kategorizimit të numrit të shtretërve si më poshtë:

Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 1- 10 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 30 netë fjetje për cdo shtrat.

Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 11- 20 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 45 netë për cdo shtrat.

Hotel,bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 21e lartë shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 60 netë për cdo shtrat.

2.Të gjitha subjektet akomoduese e kanë të detyrueshëm të bëjnë deklarimin për numrin e shtretërve dhe regjistrin të fjetjes në strukturë dhe ta paraqesin atë në Bashkinë Përmët ,për t'u sekretuar me vulë origjinale të Bashkisë.

3.Tarifa e Pastrimit për pikën Doganore "Tre Urat" të jetë 200,000 lekë.

4.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Tatim Taksave,Aseteve dhe Licencave pranë Bashkisë Përmët, Njësitë Administrative.

5.Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit në Prefekturë.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA



RELACION



Në mbështetje të nenit 54, shkronja "F", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", Paketës Fiskale të vitit 2026, miratuar me vendim nr.100, datë 04.12.2025, si dhe nisur nga fakti se një pjesë e subjekteve akomoduese nuk ka derdhur taksën e fjetjes në hotel për vitin 2025, ose dhe ata që e kanë derdhur nuk kanë bërë deklarin e sakt konform ligjit në fuqi, njëkohësisht mos miratimi nga Prefekti i Vendimit nr.89, datë 22.10.2025, po risjellim dhe njëhërë në Këshillin Bashkiak për miratim të niveleve për taksën e fjetjes në hotel sipas kategorizimit të numrit të shtretërve si më poshtë:

- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 1- 10 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 30 netë fjetje për cdo shtratë.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 11- 20 shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 45 netë për cdo shtratë.
- Hotel, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese që në strukturat e tyre kanë nga 21 e lartë shtretër taksa e fjetjes ne hotel do të llogaritet për 60 netë për cdo shtratë.

Të gjitha subjektet akomoduese e kanë të detyrueshëm të bëjnë deklarin e rregjistrimit të fjetjes në strukturë dhe ta paraqesin atë në Bashkinë Përmet për t'u sekretuar me vulë origjinale të Bashkisë.

Nga punonjësit e sektorit të Tatim Taksave, Aseteve dhe Licencave, është punuar maksimalisht për evidentimin e subjekteve që kanë struktura akomoduese, me dalje në terren, identifikim nëpërmjet faqes booking etj, kanë takuar subjekte të këtyre strukturave, kanë kërkuar rregjistrat e tyre dhe nuk i kanë paraqitur. Po kështu u kanë kërkuar të paraqiten pranë sektorit të tyre për të bërë deklarin për numrin e shtretërve dhe fjetjet dhe nuk janë paraqitur.

Realizimi i taksës së fjetjes në hotel për periudhën raportuese 2025 është 307,475 lekë ose në përqindje me planin vjetor 61.4 %.

2. Njëkohësisht me kërkesë të Strukturës Doganore të Tre Urave me shkresën nr.91, datë 11.02.2026, për kryerjen e shërbimit të pastrimit me Bashkinë Përmet, po ju sjellim për miratim dhe tarifen e pastrimit për këtë pikë doganore në vlerën 200,000 lekë.

Ju faleminderit !

Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave

Dorjan Metko

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik

Etleva Myftari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ datë ____ . ____ . 2026

**PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË NGASTRAVE PYJORE DHE KULLUSORE TË GATSHME
PËR TU DHËNË NË PËRDORIM PËR KULLOTË PËR VITET 2026-2027**

Kryetari i Bashkisë, pasi shqyrtoi relacionin "Për miratimin e listës së ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë për vitet 2026-2027" të paraqitur nga Sektori i Pyejeve dhe Kullotave, bazuar në Ligjin 139/2015 për "*Vetqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligji nr.8743 datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*" i ndryshuar, Ligji nr.8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" i ndryshuar, Ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "*Për fondin kullor*" i ndryshuar, VKM nr.433 date 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive*" ndryshuar me VKM 398 datë 13.05.2020, Udhëzimin nr.2 datë 20.07.2016 i Ministrisë së Mjedisit dhe ligjin "*Për fondin kullor*":

Me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e ngastrave pyjore dhe kullusore të gatshme për tu dhënë në përdorim për kullotë, për vitet 2026-2027 sipas listës bashkëlidhur.
2. Dhënia në përdorim e pasurisë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të kryhet sipas rregullave dhe procedurave të shpalljes të përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 20.07.2016 i Ministrisë së Mjedisit dhe ligjin "*Për fondin kullor*"
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Pyejeve dhe Kullotave në Bashkinë Përmet.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

KRYETARI I BASHKISË

Alm. HOXHA





RELACION

Mbeshtetur Udhezimit te Ministrise se Mjedisit Nr.2 dt.20.07.2016 per kriteret Teknike dhe procedurat per dhenien e ngastrave pyjore dhe kullosore ne perdorim "Struktura Pergjegjese per pyjet e kullotat ne Bashki ben planifikimin e siperfaqeve pyjore dhe kullosore qe do te jepen ne perdorim dhe Brenda muajit Shkurt ben miratimin e tyre nga Keshilli Bashkiak.

Nga studimi I kryer mendojme te japim ne perdorim per vitin 26-27 nje siperfaqe totale prej 7879.45 ha nga kjo siperfaqe e dobishme prej 5865.15 ha me nje kapacitet kullosor prej 21891 krere dhen ,8608 krere dhi 667 krere te trasha.

Keto te dhena jane planifikuar per kushtet optimal ku perfshihet infrastruktura perkatese si lera korrita,kryerje permiresimi, pastrim kullote etj..

Prandaj kerkojme miratimin e ketyre siperfaqeve per dhenie ne perdorim si kullota gje e cila do te gjeneroje te ardhura per Bashjkine Permet. .

Bashkangjitur po ju dergojme dhe evidencen e ngastrave qe do te jepen ne perdorim ne te jane dhe te dhenat perkatese si siperfaqe totale, siperfaqe e dobishme , kapaciteti kullosor si dhe lloji I kullotes (verore ose dimerore)

PERGJ.SEK. PYJE-KULLOTA

Ing.Thanas NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ dt ____/____/2026

**PËR MIRATIMIN E HEQJES DORË NGA KONTRATA DHE BANESA SOCIALE
ME Nr. PASURIE 28/55+1-14 LAGJA Z.B.U NË PRONËSI TË BASHKISË PËRMET
NË FAVOR TË PËRFITUESIT JANI BEQO TË PËRFITUAR ME VENDIMIN E
KËSHILLIT BASHKIAK Nr.104 datë 27.11.2024**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën ____/____/2026, Bazuar në Ligjin Nr. 22/2018 'Për Strehimin Social,' në mbështetje të nenit 3, neni 8 pika 2, nenin 9 pika 1, nën-pika 1.1 shkronja 'a' dhe 'b', neni 24, neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr.139/2015 'Për Vetëqeverisjen Vendore 'të ndryshuar, V.K.M Nr.459 datë 03.07.2019 'Për rregullat për subvencionimin e qerasë dhe mënyrën e financimit' pika 2/b dhe pika 10, vendimi Nr 301 datë 15.04.2020 'Për normat e strehimit si dhe kushtet e standartet për banesa sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët' vendim Nr.384 datë 12.06.2019 'Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim pas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga Organet e vetëqeverisjes Vendore' Ligji Nr.121/2016 'Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë 'pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra e Strehimit dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë heqjen dorë të shtetasit Jani Beqo për të banuar në banesën sociale me Nr. pasurie 28/55+1-14 lagja Z.B.U në pronësi të Bashkisë Përmet.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura.

KRYETARI BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 16.01.2026

RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Përmet ka në pronësi banesën sociale 83/3 të ndodhur në qytetin e Përmetit në lagjen ZBU. Kjo pronë është përfutur nga kalimi në pronësi nga Enti Kombëtar i Banesave. Aktualisht në këtë banesë jetojnë me qira sociale 9 familje të cilat janë duke kryer procedurat për kontratat e shtitjes me rezervë ose blerje të menjëherëshme në bazë të Vendimit Nr. 898, datë 18.11.2020 Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banesë të paprivatizuara.

Banesa sociale me Nr 83/3 apartamenti 1+1 me Nr pasurie 28/55+1-14 me sip 43.9 m² ndodhet në Qytetin Përmet në pjesën jugore të tij, Lagja "ZBU" e ndërtuar nga EKB në vitin 2007 dhe ka kaluar në pronësi të Bashkisë.

Bazuar në Ligjin Nr. 22/2018 Për Strehimin Social, neni 2 pika 5 – 6, neni 11 Llojet e programeve sociale të strehimit pika 1, neni 26 "Administrimi dhe mirëmbajtja e banesave sociale me qera" pika 1, me Vendim të Këshillit të Bashkisë Përmet: Nr.104 datë 27.11.2024 është vendosur që familja e z.Jani Beqo me një fëmijë autik dhe me të ardhura të pakta, të strehoet në banesën sociale 83/3, pasuria Nr.28/55+1-14 në lagjen Z.B.U për një afat një vjeçar.

Në datën 18.09.2025, z. Jani Beqo ka paraqitur pranë zyrës së strehimit se me vullnetin e tij heq dorë nga kontrata dhe banesa që ka përfutur nga shërbimi social i bashkisë Përmet me arsyetimin se nuk ka përpuethshmëri të kushteve të tij familjare.

Bazuar në procesverbalet e kryera nga komisioni në datat 29.08.2025, 08.09.2025 dhe 16.09.2025 për verifikimin në terren për praninë fizike të z.Jani Beqo në këtë banesë, u konstatua se banesa nuk është e banuar nga përfutuesi i kontratës.

Në këto kushte kjo banesë është e lirë dhe mund të përdoret për të ndihmuar një familje tjetër që është në kushte të vështira.

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkatës.

Drejtori i Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ .2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-në NR.105 DATË 04.12.2025 PËR MIRATIMIN E KUOTAVE USHQIMORE PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE NË ÇERDHE DHE KOPËSHTIN ME DREKË NË BASHKINË PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhmin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB-në nr.113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e bashkise viti 2026, VKB-në nr.105 datë 04.12.2025 “Për miratimin e kuotave ushqimore për trajtimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet”, Ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 36, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, VKM-në Nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë i ndryshuar me VKM-në Nr. 504, datë 10.9.2025; VKM-në nr.768, datë 13.12.2024 dhe VKM-në nr.67, datë 29.1.2025 neni 13/4, shkresën nr.4085 prot datë 05.12.2025 drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e shërbimit me objekt “Blerje ushqime për Çerdhen dhe Kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet për vitin 2026” LOTI i I Blerje buke gruri dhe simite nr.570 prot datë 11.02.2026, LOTI i II Blerje bulmet dhe produktet e tij nr.566 prot datë 11.02.2026, LOTI i III Blerje veze nr.568 prot datë 11.02.2026 , LOTI i IV Blerje mish i kuq dhe produktet e tij nr.569 prot datë 11.02.2026; LOTI i V Blerje mish pule nr.567 prot datë 11.02.2026, LOTI i VII Blerje ushqime koloniale nr.571 prot datë 11.02.2026, LOTI i VIII Blerje fruta perime nr.565 prot datë 11.02.2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në ÇERDHE me çmimet reja është në vlerën 168.95 lekë nga 225 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 56.05 lekë.
- Nga kjo shumë vlere prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
- Dhe vlere prej 89 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 32.95 lekë.



2. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në KOPËSHT ME DREKË me çmimet reja është në vlerën 204.39 lekë nga 266 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 61.61 lekë.
 - Nga kjo shumë vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
 - Dhe vlera prej 130 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 68.39 lekë.
3. Shpenzimet për mbulimin dhe blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i vitit 2026.
4. Efektet e zbatimit të këtij vendimi do të nisin që prej lidhjes së kontratave me secilin Operator Ekonomik për secilin lot.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social/Arsim/Kulturë/Sporte, Drejtoria e Kopshteve dhe Drejtoria e Financës/Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



RELACION

PËR NJË NDRYSHIM NË VKB-në NR.105 DATË 04.12.2025 PËR MIRATIMIN E KUOTAVE USHQIMORE PËR TRAJTIMIN E FËMIJËVE NË ÇERDHE DHE KOPËSHTIN ME DREKË NË BASHKINË PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhmin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB-në nr.113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e bashkisë viti 2026”, VKB-në nr.105 datë 04.12.2025 “Për miratimin e kuotave ushqimore për trajtimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet”.

Në mbështetje të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar neni 36, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, VKM-në Nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë i ndryshuar me VKM-në Nr. 504, datë 10.9.2025; VKM-në nr.768, datë 13.12.2024 dhe VKM-në nr.67, datë 29.1.2025 neni 13/4 Bashkia Përmet me shkresën nr.4085 prot datë 05.12.2025 ju drejtua Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara për kryerjen e shërbimit me objekt “Blerje ushqime për Çerdhen dhe Kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet për vitin 2026”. Nga Operatori Blerjeve të Përqëndruara u finalizua procedura me shpalljen e operatorëve fitues për 7(shtatë) lote si më poshtë:

- LOTI i I Blerje buke gruri dhe simite
- LOTI i II Blerje bulmet dhe produktet e tij
- LOTI i III Blerje veze
- LOTI i IV Blerje mish i kuq dhe produktet e tij
- LOTI i V Blerje mish pule
- LOTI i VIII Blerje fruta perime
- LOTI i VII Blerje ushqime koloniale

Referuar kontratave të lidhura me secilin operator fitues për secilin lot nga fondi limit i përlllogaritur për shkak të uljes së çmimeve në ofertat e paraqitura u kursye një fond prej 183 466,16 lekë në strukturën e Çerdhes dhe 428 545,91 lekë në strukturën e Kopshtit.

Bazuar në VKB-së nr.105 datë 04.12.2025 “Për miratimin e kuotave ushqimore për trajtimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopshtin me drekë në Bashkinë Përmet” si dhe në menunë ditore në kopsht dhe çerdhe u rillogaritën dhe njëherë menutë ditore me çmimet e reja për secilin produkt sipas gramaturës që përmban menuja e miratuar.



Pas kësaj analize duke qenë se menutë ditore janë të ndryshme gjatë 5(pesë) ditëve të javës u vendos që kursimi i fondit që ka ardhur pas zhvillimit të procedurës së prokurimit të detajohet si më poshtë:

1. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në ÇERDHE me çmimet reja është në vlerën 168.95 lekë nga 225 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 56.05 lekë.
 - Nga kjo shumë vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
 - Dhe vlera prej 89 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 32.95 lekë.
2. Kuota ushqimore mesatare javore për trajtimin e fëmijëve në KOPËSHT ME DREKË me çmimet reja është në vlerën 204.39 lekë nga 266 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 61.61 lekë.
 - Nga kjo shumë vlera prej 136 lekë do të mbulohet nga prindërit.
 - Dhe vlera prej 130 lekë që mbulohej më parë nga Buxheti i Bashkisë do të zbresi në vlerën 68.39 lekë.

DREJTORESHA E KOPSHTEVE
Manjola MEHMETI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



P/VENDIM

Nr. ____ datë ____/____/2026

PËR

**NJOHJEN ME BUXHETIN E ALOKUAR NGA FONDI SOCIAL PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT “PËRQAFIMI I SHPRESËS, NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË” VITI
2026 DHE BASHKËFINANCIMI I BASHKISË PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin Nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, VKB Nr. 113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026”; VKB Nr. 79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr. 72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», VKM Nr. 111 datë 23.02.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, i ndryshuar me VKM Nr. 613/2024; VKB Nr. 10 datë 30.01.2025 “Për njohjen me marrëveshjen Nr. 72 datë 13.01.2025, midis SHSSH dhe Bashkisë Përmet”; Vendim Nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 454/2 datë 22.01.2026, Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 592/1 datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit social në nivel bashkie”, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Njohjen me buxhetin e alokuar nga **Fondi Social për vitin 2026** (60% për vitin e dytë të ofrimit të shërbimit), për projektin “Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë” dhe buxhetin e alokuar nga **Bashkia Përmet si pjesë e bashkëfinancimit** (40% në vitin e dytë të ofrimit të shërbimit), detajuar si më poshtë:

Nr	Shërbim gjysmë ditor për kategoritë në nevojë	600	601	602	Financim Fondi Social	Bashkëfinancim Bashkia Përmet
1	Koordinator i qendrës	606 183	92 774		698 957	
2	Ndihmës kuzhinieri (287.3 lekë/orë x 4 orë/ditë x 22 ditë)	306 348			306 348	
3	Ushqime (240 kuota ditore)			2 940 000	1 562 870	1 377 130
4	Produkte higjienike			120 000		120 000

5	Aktivite sociale			60 000	30 000	30 000
6	Kosto Staf	54 987				54 987
	Operatori Blerjeve të Përqëndruara			150 000		150 000
					2 598 175	1 732 117

2. Përqindja e financimit të Bashkisë Përmet planifikohet në strukturën e veçantë buxhetore V043AAK, në kuadër të programit buxhetor 10430 "Përkujdesi social", për shërbimet e mbështetura rishtazi në kuadër të Fondit Social 2026, referuar Udhëzuesit të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe Vendimit nr. 111, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", i ndryshuar me VKM nr. 613/2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financë, Drejtoria e Projekteve, Integritetit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave dhe Drejtoria e Shërbimit Social.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më 12.02.2026

RELACION

PËR

**NJOHJEN ME BUXHETIN E ALOKUAR NGA FONDI SOCIAL PËR ZBATIMIN E
PROJEKTIT “PËRQAFIMI I SHPRESËS, NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË” VITI
2026 DHE BASHKËFINANCIMI I BASHKISË PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin Nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, VKB Nr. 113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026”; VKB Nr. 79 datë 23.10.2024 “Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr. 72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë», VKM Nr. 111 datë 23.02.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”, I ndryshuar me VKM Nr. 613/2024; VKB Nr. 10 datë 30.01.2025 “Për njohjen me marrëveshjen Nr. 72 datë 13.01.2025, midis SHSSH dhe Bashkisë Përmet”; Vendim Nr. 776 datë 19.12.2025 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 454/2 datë 22.01.2026, Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 592/1 datë 30.01.2026 “Transferim fondesh për financimin e shërbimeve të përkujdesit social në nivel bashkie”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, po ju paraqesim informacion për alokimin e buxhetit të projektit për vitin 2026:

Bashkia Përmet është në vitin e dytë të zbatimit të projektit “Përfaqimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë” financuar nga Fondi Social Shtetëror. Sipas Marrëveshjes së Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet në vitin e dytë të zbatimit rritet pjesa e bashkëfinancimit të bashkisë dhe konkretisht në masën 40%.

Shkresa e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr. 454/2 datë 22.01.2026, njofton financimin e kontributit të kërkuar nga Fondi Social për Bashkinë Përmet, në masën 60% e kostos së shërbimit pra 2 598 175 Lekë për vitin 2026.

Më poshtë gjeni detajimet e zërave të buxhetit të projektit të planifikuara për vitin 2026:

Nr	Shërbim gjysmë ditor për kategoritë në nevojë	600	601	602	Financim Fondi Social	Bashkëfinancim Bashkia Përmet
1	Koordinator i qendrës	606 183	92 774		698 957	
2	Ndihmës kuzhinieri (287.3 lekë/orë x 4 orë/ditë x 22 ditë)	306 348			306 348	

3	Ushqime (240 kuota ditore)			2 940 000	1 562 870	1 377 130
4	Produkte higjenike			120 000		120 000
5	Aktivitete sociale			60 000	30 000	30 000
6	Kosto Stafi	54 987				54 987
7	Operatori Blerjeve të Përqëndruara			150 000		150 000
					2 598 175	1 732 117

Pjesa e bashkëfinancimit do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Përmet, planifikuar në strukturën buxhetore V043AAK, në kuadër të programit buxhetor 10430 "Përkujdesi social", për shërbimet e mbështetura rishtazi në kuadër të Fondit Social 2026, referuar Udhëzuesit të Ministrisë së Financave nr. 02, datë 14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026" dhe Vendimit nr. 111, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social", i ndryshuar me VKM nr. 613/2024. Pjesë e bashkëfinancimit është planifikuar edhe kosto stafi, angazhim i 4 punonjësve me orë të reduktuara për ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve të projektit duke tejkaluar vlerën e bashkëfinancimit mbi 40%. Stafi i angazhaur mbulohet nga struktura AA135.V111AAA / AC135.V043AAA / AC139.V912AAA.

Faleminderit

Drejtoria e Projekteve të Huaja/Integritimit Evropian/ Performancës dhe Dixhitalizimit të të dhënave

Klaudja Ciko






REPUBLIKA E SHQIPËRIS

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Datë _____._____.2026

Për

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " ,Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ",Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar , Ligji Nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", Vendimi i KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj", , Vendim Nr. 89, datë 14.02. 2018 Për Miratimin e Kushteve dhe përcaktimin e Rregullave për Transportin Rrugor të Nxënësve të Arsimit Parashkollor, Profesional, Parauniversitar dhe të Studentëve,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI

1. Të miratojë listën emërore dhe pagesën e nxënësve për rimbursimin e transportit të tyre në vlerën 216.000 (dyqind e njëzetë e gjashtë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1.	Agathii	Altin	Dako	në shumën	12.000	(dymbëdhjetë mijë) lekë
2.	Grisejdi	Bledar	Nauni	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë.
3.	Jurgen	Aurel	Kole	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë
4.	Adenis	Adrian	Gele	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë.
5.	Kloert	Aurel	Kole	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë
6.	Klajdi	Klodian	Cullufe	në shumën	16.000	(gjashtëmbëdhjetë mijë)lekë
7.	Enea	Hysen	Nurka	në shumën	16.000	(gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë



8.	Joan Ilirjan	Tanuci	në shumën	12.000	(dymbëdhjetë mijë) lekë
9.	Shejla Pelivan	Bajrami	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
10.	Marsida Arben	Malke	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
11.	Damian Bilbil	Malkë	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
12.	Qani Neki	Hoxha	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
13.	Endri Adriatik	Telha	në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë
14.	Aleksandër Klodian Shaho		në shumën	10.000	(dhjetë mijë) lekë

2. Pagesa do të bëhet nga struktura buxhetore

AC 135.01.V043AAK. 606, në shumën 216 000 lekë

3. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 305.000 treqind e pesë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1	Adriana Lahe	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë
2.	Violeta Ballabani	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë .
3.	Liri Mançellari	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë
4.	Vasil Vlashi	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë.
5.	Lifter Bango	në shumën	25.000	(njëzetë e pesë mijë) lekë.
6.	Flutura Beqo	në shumën	20.000	(njëzetë mijë) lekë
7.	Sentiljano Jaupaj	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë.
8.	Lorena Zyberi	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë
9.	Albert Mullaraj	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë
10.	Adriana Kola	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë
11.	Durim Elmazi	në shumën	30.000	(tridhjetë mijë) lekë

4. Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 305 000 lekë

5.Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 01,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 305.000 lekë

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më ____ . ____ . 2026

RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Shtetësja Lorena Zyberi ,banuese në Përmet ka bërë kërkesë Nr.91 Prot datë 12.01.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është nënë kryefamiljare ,e vetme,pa punë,e sëmurë dhe jeton në kushte shumë të vështira ekonomike,me një fëmijë i cili ka nevojë për përkujdesje dhe nuk ka të ardhura për rritjen e tij.

Pranë bashkisë është paraqitur kërkesë me Nr.161 Prot datë 15.01.2026 nga shtetësja Flutura Beqo banuese në Përmet për t'u ndihmuar financiarisht,pasi është shtetase e vetmuar,e papunë në kushte shumë të vështira ekonomike dhe nuk ka të ardhura për të përballuar jetesën.

Edhe shtetasi Sentiljano Jaupaj banues në fshatin Kosinë ka paraqitur kërkesë Nr.171 Prot datë 16.01.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është person i sëmurë me P.A.K,kryefamiljar me dy fëmijë të vegjël në kushte të vështira ekonomike dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën.

Shtetësja Violeta Ballabani banuese në fshatin Kosinë ka paraqitur kërkesë Nr.176 Prot datë 16.01.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi jeton me pensionin e bashkëshortit dhe ai nuk i mjafton për të përballuar shpenzimet pasi është me problem shëndetësore.

Shtetësi Albert Mullaraj banues në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.173 Prot datë 16.01.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është e sëmurë dhe kurat për kimioterapi janë shumë të shtrenjta.

Shtetasi Vasil Vlashi banues në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.435 Prot datë 02.02.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi ka kryer një operacion dhe kura për kurimin e sëmundjes kushton shumë dhe nuk ka mundësi për t'i blerë.

Pranë bashkisë ka paraqitur kërkesë Nr.464 Prot datë 08.02.2026 edhe shtetësja Liri Mançellari,banuese në Përmet e cila kërkon të ndihmoet financiarisht pasi është person me P.A.K. dhe pagesa që përfiton nuk i del për të përballuar jetesën.



Edhe shtetësja Adriana Lahe banuese në Piskovë ka paraqitur kërkesë Nr.536 Prot.datë 10.02.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht për rimbursimin e transportit të fëmijës së saj Ilvano Lahe i cili mer trajtim pranë Qendrës Komunitare të fëmijëve me Aftësi Ndryshe në Përmet.

Shtetasi Lefter Bango,banues në fshatin Qilarisht ka paraqitur kërkesë Nr.4092 Prot datë 05.12.2025 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është person i vetmuar,pa pension dhe ka nevojë për të ardhura financiare.

Edhe shtetasi Durim Elmazi banuen në fshatin Mokricë por është strehuar pranë spitalit Përmet ka bërë kërkesë Nr.573 Prot datë 12.02.2026 për t'u ndihmuar financiarisht nga bashkia pasi është person I vetmuar,invalid dhe I braktisur nga familja e tij.

Njëkohësisht edhe shtetësja Adriana Kola,banuese në Përmet ka bërë kërkesë Nr.555 prot datë 11.02.2026 për t'u ndihmuar nga bashkia pasi janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe nuk përballojnë dot shpenzimet për jetesë.Janë të papunë.

Edhe shtetasi Altin Dako banues në Qilarisht ka paraqitur kërkesë Nr.349 Prot datë 29.01.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të dy fëmijëve të tij të cilët vazhdojnë shkollën 9 –vjeçare “Meleq Gosnishti”.

Shtetasi Ilirjan Tanuçi,banues në fshatin Qilarisht,ka paraqitur kërkesë Nr.356 prot datë 29.01.20262026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijës të tij i cili vazhdon shkollën 9 –vjeçare “Meleq Gosnishti”.

Me kërkesë Nr.3284 Prot datë 07.10.2025 shtetasit Adriatik Telha,Pelivan Bajrami,Gramoz Meta,përfaqësues me prokurë për shtetasin Neki Hoxha,Klodian Shaho,Bilbil Malkë banues në fshatin Pacomit kërkojnë rimbursimin e transportit të fëmijëve të tyre të cilët vazhdojnë shkollën në Përmet.

Shtetasi Bledar Nauni,banues në fshatin Bënjë ka paraqitur kërkesë Nr.599 Prot datë 13.02.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijës të tij i cili vazhdon shkollën 9 –vjeçare në Përmet

Edhe shtetasi Aurel Kole banues në fshatin Bënjë ka paraqitur kërkesë Nr.602 Prot datë 13.02.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijëve të tij të cilët vazhdojnë shkollën 9 –vjeçare në Përmet.

Njëkohësisht edhe shtetasi Adrian Gele banues në fshatin Bënjë ka paraqitur kërkesë Nr.601 Prot datë 13.02.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijës të tij i cili vazhdon shkollën 9 –vjeçare në Përmet.

Edhe shtetasi Apostol Cullufe banues në fshatin Bënjë ka paraqitur kërkesë Nr.598 Prot datë 13.02.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijës të tij i cili vazhdon shkollën 9 –vjeçare në Përmet.



Shtetasi Hysen Nurka banues në fshatin Bënjë ka paraqitur kërkesë Nr.608 Prot datë 13.02.2026 i cili kërkon rimbursimin e transportit të fëmijës të tij i cili vazhdon shkollën 9 –vjeçare në Përmet.

Njëkohësisht nxënësja Marsida Malkë banuese në fshatin Pacomit e cila vazhdon gjimnazin public “Sami Frashëri ” në Përmet do rimbursohet për transportin e saj pasi nuk ka mundësi financiare për të përballuar shpenzimet.

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” ,Ligjin Nr. 68 /2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”,Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar,Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar ,VKB Nr.113 datë 17.12.2025 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, Vendim Nr. 89, datë 14.02. 2018 Për Miratimin e Kushteve dhe përcaktimin e Rregullave për Transportin Rrugor të Nxënësve të Arsimit Parashkollor, Profesional, Parauniversitar dhe të Studentëve, kërkojmë nga ana juaj të merret në konsideratë kërkesa e shtetasve: për dhënie ndihmë financiare për nxënësit që frekuentojnë shkollën :

Agathi Altin Dako; frekuenton linjën Qilarisht-Përmet-Qilarisht e cila do përfitojë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2025-2026

Odhisea Altin Dako ; frekuenton linjën Qilarisht-Përmet-Qilarisht e cila do përfitojë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2025-2026

Joan Ilirjan Tanuci, frekuenton linjën Qilarisht-Përmet-Qilarisht i cili do përfitojë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Shejla Pelivan Bajrami frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit e cila do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Endri Adriatik Telha frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Aleksandër Klodian Shaho frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Damian Bilbil Malkë frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Qani Neki Hoxha frekuenton linjën Pacomit-Piskovë-Pacomit i cili do përfitojë 10.000 (dhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Marsida Arben Malkë frekuenton linjën Pacomit-Përmet-Pacomit e cila do përfitojë 40.000 (dyzetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Grisejd Bledar Nauni; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2025-2026.



Jurgen Aurel Kole; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë; për periudhën Janar- Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Adenis Adrian Gele, frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Kloert Aurel Kole; frekuenton linjën Bënjë-Përmet-Bënjë i cili do përfitojë 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026

Klajdi Klodian Cullufe; frekuenton linjën Buhal-Përmet-Buhal i cili do përfitojë 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

Enea Hysen Nurka frekuenton linjën Buhal-Përmet-Buhal i cili do përfitojë 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë; për periudhën Janar-Maj ,viti shkollor 2025-2026.

të cilët do përfitojnë nga fondi social 216.000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë.

Si dhe kërkesat e shtetasve :

- 1- Violeta Ballabani të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë)lekë .
- 2- Liri Maçellari të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
- 3- Vasil Vlashi të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
- 4- Lefter Bango të ndimohet përkatësisht në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.
- 5- Flutura Beqo të ndihmoet përkatësisht në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë
- 6- Sentiljano Jaupaj të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
- 7- Lorena Zyberi të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
- 8- Adriana Lahe të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
- 9- Albert Mullaraj të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
- 10- Adriana Kola të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë
- 11- Durim Elmazi të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë

Bashkengjitur i gjithë dokumentacioni përkates.

Drejtori Shërbimit Social

Arjana PAPAPANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____.2026

P/VENDIM

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
SHKURT 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore "i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike",VKM Nr617 datë 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,"Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike". VKB nr.113 datë 17.12.2025 "Per miratimin e buxhetit te bashkise per vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit te punojseve te bashkise, institucioneve ne varesi te saj "Keshilli Bashkiak me propozim te Kryetarit te Bashkise:

VENDOSI

1.Të perfitojne ndihme ekonomike për Muajin **SHKURT** 2026, **33** familje me një fond **123.500** lekë.

2.Fondet të përballohen nga struktura :

1.Gr.00.Tit.AC135.Kap.01.Art.606.Kod produkti V043AAD per shumen 123.500 lekë

3. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atesia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma/leke
1	Ziso Apostol Kristo	Valentina Polikron Kristo	3	4200
2	Xhilda Xhemal Selimllari	Xhilda Xhemal Selimllari	2	3600
3	Mitro Gani Zeqiri	Lefteri Rrapi Zeqiri	4	4700
4	Syrja Mehmet Hoxha	Beqar	1	3200
5	Drita Irakli Kosta	Divorcuar	2	3600
6	Lefteri Polikron Proko	E ve	1	3200
7	Andon Dhimitraq Kukureci	I ve	2	3600
8	Aferdita Nuredin Lahe	Beqare	1	3200
9	Arben Thoma Teka	Mirela Xheli Teka	6	5400
10	Viktor Josif Proko	Divorcuar	1	3200
11	Dhimo Naun Dimçi	Lindita Hysen Dimçi	3	4200
12	Vera Thanas Nage	E ve	2	3600
13	Leonart Petro Markaj	Kristina Petraq Markaj	3	4200



14	Thoma Aristidh Ilia	Maria Nuredin Ilia	4	4700
15	Xhensila Maksim Jahjaj	Beqare me Femijë	2	3600
16	Violeta Guce Pelushi	Beqare	1	3200
17	Engjellushe Manxho Canollari	E ve	1	3200
18	Rivelino Fatmir Doko	Hurma Leonidha Doko	4	4700
19	Bajame Fari Hysenshahaj	E ve	1	3200
20	Lida Koco Thomollari	Divorcuar	1	3200
21	Vasilika Bedri Malka	E ve	2	3600
22	Ilir Sali Jashari	Beqar	1	3200
23	Vitori Llazo Caci	Beqare	2	3600
24	Luam Ferit Zeneli	Gezime Tafil Zeneli	4	4700
25	Ilber Kudret Dalipaj	Divorcuar	1	3200
26	Kastriot Kristo Koto	Kastriot Kristo Koto	3	4200
27	Kastriot Astrit Male	Divorcuar	1	3200
28	Vangjush Thanas Mamillo	Gentiana Seit Mamillo	3	4200
29	Bari Avni Zaimi	Valbona Zenel Zaimi	2	3600
30	Kadri Petrit Maska	Beqar	1	3200
31	Dashnor Guçe Pelushaj	Vezire Ali Pelushaj	4	4700
32	Klodiana Kristofor Peçi	Divorcuar	1	3200
33	Lulëzim Barjam Beqari	Divorcuar	1	3200
	SHUMA			123.500

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Finances dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6,të nenit 55,të ligjit nr.139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË MUAJI
SHKURT 2026**

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë.20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, ligji nr.9355, date 10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore “i ndryshuar, VKM nr.869 datë 29.12.2021 për disa ndryshime në VKM nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike,VKM Nr 868 date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike”,VKM Nr.617 datë 22.09.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597,date 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave,”Për përcaktimin e procedurave,dokumentacionit dhe masës mujore,të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. VKB nr.113 datë 17.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punojësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj.Familje të cilat janë përfituese në fondin e bashkisë janë ato familje të cilat mbasi kanë bërë aplikimin në Sistemin e Ndihmës ekonomike, rekomandimin në fondin 6% nuk janë fituese. Dhe nga vizitat e kryera në familje nga Administratorët shoqëror duke parë gjëndjen ekonomike të këtyre familjeve të cilat janë në gjëndje të dobët ekonomike u arsyetua që të përfshihen në fondin e familjeve në nevojë.

Përsa më sipër rekomandojmë të ndihmohen për muajin Shkurt 33 familje me një vlerë prej 123.500 lekë.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____, 2026

P/VENDIM

Për miratimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmës ekonomike, deri në 6% .

Në mbështetje të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore “ i ndryshuar me VKM nr.868 dt.29.12.2021 “Për disa ndryshime në Vendimin 597 dt.04.09.2019 të K.M.”Për percaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të perfitimit të ndihmës ekonomike dhe perdorimit të fondit shtese,mbi fondin e kushtezuar per ndihmën ekonomike,VKM nr.85 dt.10.02.2021,nr.617,date 22.09.2022 i perditesuar: Vendimin e Keshillit Bashkiak Permet me fondet e Buxhetit Vendor.VKB nr.113 datë 17.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026 dhe percaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi të saj”. Keshilli Bashkiak,me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1.Të përfitojnë ndihmë ekonomike për Muajn Janar 2026, 6 familje me një fond prej 21.184 lekë.

2. Familjet që përfitojnë janë si më poshtë:

Nr	Emri, Atësia, Mbiemri	Bashkeshortja/i	N.ant.	Shuma
1	Ylli Guçe Pelushaj	Zylkade Qerim Pelushaj	2	3.703
2	Roland Petraq Jorgji	Divorcuar	1	2.178
3	Lame Enver Ferati	Silvana Kujtim Ferati	3	5.227
4	Mimoza Skënder Gjoka	Divorcuar	1	2.178
5	Lefteri Mihal Tyto	Divorcuar	1	5.720
6	Flavia Musa Pelushaj	Beqare	1	2.178
	SHUMA			21.184

3..Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi sektori buxhet-finance dhe zyra e ndihmës ekonomike.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimitëve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,”Për vetëqeverisjen Vendore”,(i ndryshuar).

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot.

Përmet më _____._____.2026

RELACION

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK NDIHMËS
EKONOMIKE, DERI NË 6% .**

Mbështetur në Ligjin Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar me ligjin nr.38/2019 datë 20.06.2019 ligji Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”Ligjit 935datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”I ndryshuar me VKM Nr.955 datë 07.12.2016(kreu II pika 13)dhe udhëzimi nr.5 datë 17.02.2017 pika 2 i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.Për përcaktimin kriterëve,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe VKM nr.85 dat10.02.2021,nr.868,datë 29.12.2021;n timer.617,datë 22.09.2022 i përditësuar Vendimi i,Këshillit Bashkiak Përmet me fonde të Buxhetit Vendor Nr.113 datë 17.12.2025”Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2026 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë,institucioneve në varësi të saj “Këshilli Bashkiak ka të drejtë të trajtojë me ndihmë ekonomike familjet aplikuese që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,deri 6% të bllok ndihmës ekonomike të muajit.Janar 2026 me Vendim të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Socail Gjirokastër.Nr.10/2022 datë 27/10/2022 për dhënien e NE për periudhën 01-31-2026 Për Bashkinë Përmet.(Sipas vendimit të Muajit Janar 2026).

Për sa më sipër vlera e fondit të kushtëzuar (bllok ndihma ekonomike) për Muajin Janar 2026

është 47 familje me,Shumën prej 356.254 lekë dhe për tu trajtuar familje me ndihmë ekonomike janë në dispozicion 6% e këtij fondi ose 21.378 lekë,për Muajin Janar 2025.

Mbështetur në të dhënat për dhënien e Ndhmës Ekonomike për periudhën 1-31 Janar 2026 kanë aplikuar 3 familje asedhenjë familje nuk ka dale fituese 47 janë përfituese në skemën e Ndhmës Ekonomike.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikuesve që nuk kane marë pikët e mjaftueshme për periudhën 01 Janar deri më datën 31 nga vlersimi i SH.S.SH rekumandojmë:

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar prej 6%,6 familje me një vlerë 21.184 lekë,nga ku fondi 6% në total sipas vendimit është në Shumën 21.378 difernca prej 194 lekë do të mbetet e papërdorur për muajin Janar.

Specialisti i NE

Jurigen SIMONI